

Fillimi > -Kronikë

Armëmbajtje pa leje dhe baste ‘online’, Policia shton kontrollet në Durrës, 4 të arrestuar

05 Shtator, 2021 13:32



Madhësia e tekstit: - +

DURRËS

Policia e Durrësit ka ushtruar kontrolle bënë disa zona të qytetit, ku ka evidentuar dhe arrestuar 4 persona. Në prangat e policisë ka rënë 25-vjeçari H. L., i akuzuar për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve sportive” dhe “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”.

Gjithashtu një nga të arrestuarit është dhe 50-vjeçari A. H., i dënua më parë për veprën penale “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”. Sakaq, Policia në sajë të të dhënave të siguruara në rrugë operative, ka ushtruar kontrollet në një makinë, të parkuar pranë një lokali, ku kanë gjetur një armë manovër.

Kësisoj është arrestuari shtetasi H. L. E në përfundim, është arrestuar dhe 28-vjeçari E. Z., pasi gjatë kontrolleve në lokalin e tij rezultoi se ai ushtronte aktivitetin e basteve online. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, për veprime të mëtejshme.

Njoftimi i Policisë:

Durrës
Vijojnë kontrollet e pandërprera në të gjithë qarkun e Durrësit, për evidentimin dhe goditjen e paligjshmërisë.

Vihen në prangat e Policisë 4 shtetas, për vepra të ndryshme penale.

Specialistët për Hetimin e Narkotikëve në DVP Durrës, arrestuan në flagrancë për veprën penale “Përshtatja e lokalit për përdorim droge”, shtetasin H. L., 25 vjeç dhe për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve sportive” dhe “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, shtetasin A. H., 50 vjeç, i dënua më parë për veprën penale “Prodhim dhe shitja e narkotikëve”, të dy banues në Durrës.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Durrës, pas informacioneve të mara në rrugë operative se në lokalin në meanxhim të shtetasit H. L., në lagjen nr.16, Durrës, gjendeshin sende të kundraligjshme, kanë ushtruar kontroll në ambientet e këtij lokali si dhe në automjetin në përdorim të shtetasit A. H., e cila ishte e parkuar përpara lokalit.

Gjatë kontrollit të ushtruar në automjet shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan disa doza me lëndë narkotike të dyshuar kokainë të cilat dyshohet se konsumoheshin në ambientet e lokalit në përdorim të shtetasit H. L., si dhe një armë sportive (manovër).

Specialistët për Hetimin e Krimit Ekonomik dhe Financiar në DVP Durrës arrestuan në flagrancë për veprat penale “Organizimi i lotarive të palejuara” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, shtetasin:

E. Z., 28 vjeç, banues në Durrës, pasi gjatë kontrollit të ushtruar në ambientet e lokalit që menaxhonte, u konstatua duke ushtruar aktivitetin e lotarive të basteve sportive.

Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan 5 telefona celularë, me anë të të cilëve ky shtetas ushtronte këtë aktivitet, si dhe 36.500 lekë dhe 50 euro, të dyshuara të përfutuara nga kjo veprimtari e paligjshme.

Nga specialistët e Qarkullimit Rrugor në DVP Durrës u arrestua në flagrancë shtetasi I. T., 52 vjeç, banues në Shijak, pasi u konstatua nga shërbimet e Policisë, duke drejtuar mjetin tip “Ford”, në gjendje të dehur.

Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, për veprime të mëtejshme.

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: armëmbajtje pa leje arrestime Durrës kontrolle policia

TË NGJASHME

Si nëpër filma, burri i zë pritë 46-vjeçarit në Nju Jork, e qëllon me armë pamëshirshëm (VIDEO)

10 Shtator, 2021

Mori ryshfet, arrestohet drejtori i IKMT-së në Dibër, në pranga edhe administratori i një kompanie (EMRAT)

10 Shtator, 2021


Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË



Vrasje në Fier, 31-vjeçari qëllon për vdekje me armë zjarri në banesë ish- bashkëshorten

10 Shtator, 2021



U helmuan nga ushqimi, rreth 20 dasmorë përfundojnë në spitalin e Durrësit. Nisin hetimet

10 Shtator, 2021

Ra nga kangjellat e ndryshkura të hotel “Rogner”, ja vendi ku humbi jetën i riu (Foto+Video)

10 Shtator, 2021

Hotel ‘Rogner’ shndërrohet në skenë krimi, shemben kangjellat e ballkonit, vdes tragjikisht i riu (Emri)

10 Shtator, 2021

Tentuan të kalonin kufirin me çantat plot me drogë, Policia greke ndalon 2 persona, njëri prej tyre shqiptar

10 Shtator, 2021

Aksident në aksin Lezhë-Milot, makina përplas motoçikletën, një i plagosur

10 Shtator, 2021

KATEGORIA VIDEO

Kjo Kombëtare mund të shkojë larg”, Igli Tare për Sport News: Më pëlqen shpirti i garës së kuqezinjve, brez fantastik (VIDEO)

10 Shtator, 2021

Hotel ‘Rogner’ shndërrohet në skenë krimi, shemben kangjellat e ballkonit, vdes tragjikisht i riu (Emri)

10 Shtator, 2021

“Duhet të ishte në burg”, Rama i përgjigjet akuzave të Bashës: Të mirëkuptueshme, kjo s’është ditë e lehtë për PD, duhet të kemi respekt për traumat e të tjerëve

10 Shtator, 2021

“Koha, ilaçi më i mirë”, Basha: Dhimbja që ndiej në nivel personal dhe njerëzor për vendimin është dyfishuar sot nga gjuha e Berishës

10 Shtator, 2021

“Në Kuvend pakica e krimit e korrupsionit, duhet të ishin në burg”, Basha flet me emra pas braktisjes së seancës: Detyra jonë, mposhtja e këtij regjimi

10 Shtator, 2021

Lindita Nikolla mban fjalën e saj të parë si Kryetare Kuvendi: Ndihem nderuar, ta kthejmë Parlamentin në pasuri publike, e jo në hapësirë përçarëse

10 Shtator, 2021